



Procedura e parashtrimit të ankesave para Zyrës së Avokatit të Popullit

(Miratuar më 27 shtator 2018, rishikuar më 5 maj 2020 dhe 10 shkurt 2024, hyri në fuqi
më 27 shtator 2018)

Përmbajtja

1.	Hyrje	2
2.	Juridiksioni	2
3.	Fushëveprimi	2
4.	Përkufizime	2
5.	Ankesat	3
6.	Përmbajtja e ankesave	4
7.	Procedura mbi pranueshmërinë e ankesës	5
8.	Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit të mospranueshmërisë	5
9.	Ankesat e pranueshme	6
10.	Ndërmjetësimi dhe pajtimi	6
11.	Raporti përfundimtar	7
12.	Kërkesa për rishqyrtimin e përfundimeve	7
13.	Mbrojtja e të dhënave	8
14.	Konfidencialiteti	8
15.	Çështje që nuk trajtohen përmes procedurës së parashtrimit të ankesave	9
16.	Ndryshimet	9
17.	Hyrja në fuqi	9



1. Hyrje

- 1.1. Në përputhje me amendamentin nr. 24 të Kushtetutës, nenin 162(11) të Kushtetutës dhe nenin 34(9) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji nr. 05/L-053, ku parashihet krijimi i Zyrës së Avokatit të Popullit në kuadër të Dhomave të Specializuara të Kosovës me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar;
- 1.2. Në bazë të rregullës 28 dhe rregullës 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, e cila hyri në fuqi më 5 korrik 2017 dhe ku përcaktohen roli dhe funksionet e Avokatit të Popullit¹;
- 1.3. Duke mbajtur parasysh pavarësinë e Avokatit të Popullit në ushtrimin e funksioneve të veta;
- 1.4. Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës nxjerr Procedurën e parashtrimit të ankesave si më poshtë.

2. Juridiksioni

- 2.1. Avokati i Popullit është i pavarur në monitorimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës, të personave që kanë kontakt me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
- 2.2. Avokati i Popullit ka përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, kudo ku ushtrohen funksionet e tyre.

3. Fushëveprimi

- 3.1. Procedura e parashtrimit të ankesave vlen për të gjithë personat që duan t'i parashtrojnë ankesë Zyrës së Avokatit të Popullit, si dhe për përfaqësuesit e tyre, sipas rastit.
- 3.2. Procedura e parashtrimit të ankesave vlen edhe për organin përkatës, përkatësisht Dhomat, Zyra Administrative ose Zyra e Prokurorit të Specializuar, sipas rastit.

4. Përkufizime

- 4.1. Në kuadër të procedurës së parashtrimit të ankesave:
 - 4.1.1. "*Organi përkatës*" është organi konkret i cili është objekt i ankesës së parashtruar, përkatësisht Dhomat, Zyra Administrative ose Zyra e Prokurorit të Specializuar, sipas rastit;
 - 4.1.2. "*Dhomat*" është organi i Dhomave të Specializuara i përcaktuar në nenin 24(1)(a) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji nr. 05/L-53;

¹ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017 dhe ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020.



- 4.1.3. *“Komunikimet me organin përkatës”* është komunikimi midis Zyrës së Avokatit të Popullit dhe organit përkatës, i cili kryhet gjithmonë nëpërmjet kreut të organit përkatës, gjegjësisht Kryetarit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, Administratorit ose Prokurorit të Specializuar, sipas rastit;
- 4.1.4. *“Parashtruesi i Ankesës”* është personi që i parashtron ankesën Zyrës së Avokatit të Popullit në të cilën pretendon shkelje prej Dhomave, Zyrës Administrative ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të të drejtave dhe lirive themelore të veta, të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës;
- 4.1.5. *“Ligji”* është Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji nr. 05/L-53;
- 4.1.6. *“Avokati i Popullit”* është personi i emëruar nga Autoriteti Emërues në përputhje me dispozitat e nenit 34(9) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji nr. 05/L-53, dhe amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Kosovës, neni 162(11);
- 4.1.7. *“Zyra e Avokatit të Popullit”* nënkupton Avokatin e Popullit dhe personelin e kësaj Zyre;
- 4.1.8. *“Zyra Administrative”* është organi i Dhomave të Specializuara i përcaktuar në nenin 24(1)(b) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji nr. 05/L-53;
- 4.1.9. *“Përfaqësuesi”* është personi i autorizuar me anë të një autorizimi të nënshkruar për të parashtruar ankesë në emër të personit që pretendon shkelje prej Dhomave, Zyrës Administrative ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të të drejtave dhe lirive themelore të veta të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Përfaqësues është edhe personi i cili përfaqëson parashtruesin e ankesës gjatë hetimit para Zyrës së Avokatit të Popullit;
- 4.1.10. *“Rregullorja e Procedurës dhe e Provave”* është Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, që hyri në fuqi më 5 korrik 2017²;
- 4.1.11. *“Dhomat e Specializuara”* nënkupton Dhomat e Specializuara, ku përfshihen Dhomat dhe Zyra Administrative, përcaktuar në nenin 24(1) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji nr. 05/L-53; dhe
- 4.1.12. *“Zyra e Prokurorit të Specializuar”* është Zyra e Prokurorit të Specializuar sikurse përcaktohet në nenin 35 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji nr. 05/L-53.

5. Ankesat

- 5.1. Të gjithë personat që plotësojnë kushtet e parapara në rregullën 28(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave mund të parashtrojnë ankesë ku të pretendojnë shkelje prej

² Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017 dhe ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020.



- Dhomave, Zyrës Administrative ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të të drejtave dhe lirive themelore të tyre, të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës.
- 5.2. Në përputhje me rregullën 29(2)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, ankesa e parashtruar prej përfaqësuesit dorëzohet bashkë me autorizimin e nënshkruar që vërteton dhënien e pëlqimit prej parashtruesit të ankesës.
 - 5.3. Ankesa me shkrim dorëzohet në formë të shkruar, qoftë elektronikisht apo në letër. Zyra e Avokatit të Popullit merr masat përkatëse për t'i ndihmuar personat me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së tyre për parashtrim të ankesës. Në rrethana të jashtëzakonshme, Avokati i Popullit mund të pranojë ankesa të parashtruara gojarisht. Këto ankesa dokumentohen zyrtarisht me shkrim.
 - 5.4. Ankesa parashtrohet duke përdorur formularin e ankesës që gjendet në faqen në Internet të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në gjuhët zyrtare (shqipe, serbishte, anglishte).
 - 5.5. Ankesa i parashtrohet Zyrës së Avokatit të Popullit në një nga tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (shqipe, serbishte ose anglishte). Përgjigjet dhe e gjithë korrespondenca e Zyrës së Avokatit të Popullit në lidhje me ankesën janë në të njëjtën gjuhë zyrtare.
 - 5.6. Ankesa parashtrohet brenda gjashtë muajsh nga data e shkeljes së pretenduar, përveçse kur jepen arsye bindëse për mosdorëzimin e saj brenda këtij afati.
 - 5.7. Avokati i Popullit nuk ndërhyt në çështje gjyqësore ose procedura të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, me përjashtim të rasteve në lidhje me vonesa të paarsyeshme.

6. Përmbajtja e ankesave

- 5.1 Në ankesë shënohen:
 - 6.1.1. emri, adresa, datëlindja dhe profesioni i parashtruesit të ankesës, si dhe numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike (email), nëse ka;
 - 6.1.2. emri, adresa, datëlindja dhe profesioni i përfaqësuesit, si dhe numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike, nëse ka;
 - 6.1.3. organi përkatës që është objekt i ankesës, që do të thotë Dhomat, Zyra Administrative ose Zyra e Prokurorit të Specializuar, sipas rastit;
 - 6.1.4. një përshkrim i çështjes që përbën objektin e ankesës dhe kohën kur parashtruesi i ankesës është vënë në dijeni të asaj çështjeje;
 - 6.1.5. një përshkrim i shkeljes së pretenduar dhe mjete juridik që kërkohet;
 - 6.1.6. të dhëna për përpjekjet e parashtruesit të ankesës ose të përfaqësuesit të tij për të kontaktuar çfarëdo organi ose institucioni tjetër në lidhje me objektin e ankesës, si edhe rezultatin e përpjekjeve të tilla, nëse është e zbatueshme;
 - 6.1.7. të dhëna nëse objekti i ankesës tashmë ka gjetur zgjidhje, ose është për shqyrtim para një gjykate apo institucioni tjetër;
 - 6.1.8. një deklaratë ku parashtruesi i ankesës bën të ditur nëse ka kundërshtim që Zyra e Avokatit të Popullit t'ia publikojë emrin gjatë shqyrtimit të ankesës, si dhe arsyet për kundërshtimin; dhe



- 6.1.9. çfarëdo informacioni tjetër që mund të ketë rëndësi për ankesën.
- 6.2. Parashtruesi i ankesës paraqet të gjitha provat shkresore që zotëron në mbështetje të ankesës. Parashtruesi i ankesës dorëzon vetëm kopjet e dokumenteve origjinale dhe mban dokumentet origjinale.
- 6.3. Parashtruesi i ankesës shënon qartë çfarëdo dokumenti apo informacioni që e konsideron konfidencial në momentin kur ia dërgon Zyrës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit që t'ia kalojë informacionin organit përkatës në qoftë se e gjykon të nevojshme, në përputhje me Pjesën 14.

7. Procedura mbi pranueshmërinë e ankesës

- 7.1. Avokati i Popullit vendos nëse një ankesë është e pranueshme. Për marrjen e vendimit, Avokati i Popullit mund t'i kërkojë parashtruesit të ankesës informacion apo dokumente shtesë në çfarëdo momenti gjatë procedurës në vijim.
- 7.2. Për marrjen e vendimit mbi pranueshmërinë e ankesës, Avokati i Popullit mund të kërkojë mendimin e organit përkatës.
- 7.3. Parashtruesi i ankesës mund t'i parashtrojë Avokatit të Popullit kundërpërgjigjen e vet pas marrjes së përgjigjes nga organi përkatës lidhur me pranueshmërinë e ankesës.
- 7.4. Ankesa konsiderohet e papranueshme në qoftë se:
- 7.4.1. ka të bëjë me një çështje gjyqësore ose procedura të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara dhe jo me një pretendim për vonesë të paarsyeshme;
 - 7.4.2. është jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit;
 - 7.4.3. nuk është parashtruar brenda afatit prej gjashtë muajsh nga data e shkeljes së pretenduar, përveçse kur jepen arsye bindëse për mosdorëzimin e saj brenda këtij afati;
 - 7.4.4. është e paplotë dhe nuk është plotësuar edhe pas kërkesës së Avokatit të Popullit;
 - 7.4.5. nuk janë shfrytëzuar mjete juridike të tjera, përveçse në rast mosveprimi apo rrethanave më të ngutshme, për të parandaluar dëm të rëndë dhe padrejtësi të pandreqshme;
 - 7.4.6. është e pavlerë; dhe/ose
 - 7.4.7. është qëllimkeqe.
- 7.5. Në qoftë se ankesa gjykohet e papranueshme, Avokati i Popullit nxjerr një vendim të arsyetuar që përfundon procedurën. Ky vendim i komunikohet parashtruesit të ankesës sa më shpejt që të jetë e realizueshme.

8. Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit të mospranueshmërisë

- 8.1. Në rast se zbulohet një fakt i ri për të cilin parashtruesi i ankesës nuk ka pasur dijeni në kohën e nxjerrjes së vendimit të mospranueshmërisë; në rast se një fakt i tillë nuk mund të ishte zbuluar nëpërmjet ushtrimit të zellit të duhur dhe mund të kishte qenë faktor vendimtar për vendimin,



brenda një afati të arsyeshëm pasi është vënë në dijeni të faktit, parashtruesi i ankesës mund t'i bëjë kërkesë Avokatit të Popullit për rishqyrtimin e pranueshmërisë së ankesës.

- 8.2. Parashtruesi i ankesës ka detyrimin të provojë përmbushjen e kriterëve të Pjesës 8.1.
- 8.3. Në qoftë se bindet se janë përmbushur kriteret për rishqyrtimin e pranueshmërisë së ankesës, Avokati i Popullit ia komunikon këtë vendim parashtruesit të ankesës. Rishqyrtimi kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Pjesës 7.

9. Ankesat e pranueshme

- 9.1. Pas të ketë vendosur së një ankesë është e pranueshme, Avokati i Popullit nis hetimin.
- 9.2. Zyra e Avokatit të Popullit njofton parashtruesin e ankesës dhe organin përkatës për nisjen e hetimit.
- 9.3. Avokati i Popullit i jep organit përkatës mundësinë për të parashtruar përgjigjen e vet ndaj pretendimeve të paraqitura në ankesë. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund t'i kërkojë organit përkatës që në përgjigjen e vet të trajtojë aspekte konkrete të pretendimeve, si edhe çështje konkrete që dalin prej ankesës ose që kanë lidhje me të.
- 9.4. Në rast se synon të kthejë përgjigje, organi përkatës e dorëzon atë brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e të dhënave të ankesës. Avokati i Popullit mund ta zgjasë këtë afat në qoftë se organi përkatës i paraqet arsye bindëse për këtë.
- 9.5. Pas përgjigjes së organit përkatës lidhur me meritat e ankesës, parashtruesi i ankesës mund t'i parashtrojë Avokatit të Popullit kundërpërgjigjen e vet.
- 9.6. Në çdo moment gjatë hetimit, Avokati i Popullit mund t'i kërkojë organit përkatës të dorëzojë informacion ose material plotësues që ka në zotërim. Pas këshillimeve me organin përkatës, Avokati i Popullit mund të inspektojë materialet ose mjediset përkatëse. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të kërkojë takim me organin përkatës për qartësimin e çështjeve që janë objekt i hetimit.
- 9.7. Për nevojat e kryerjes së hetimit, Avokati i Popullit mund t'i kërkojë parashtruesit të ankesës ose një pale të tretë të dorëzojnë informacion apo material, ose të qartësojnë informacionin apo materialin e dorëzuar. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të kërkojë takim me parashtruesin e ankesës për qartësimin e çështjeve që janë objekt i hetimit.
- 9.8. Avokati i Popullit mund të autorizojë analiza ose aktekspertiza që i gjykon të nevojshme dhe të rëndësishme për hetimin.
- 9.9. Në qoftë se vihet në dijeni se çështjet që i heton janë bërë lëndë e procedurave ligjore, Avokati i Popullit përfundon hetimin pas këshillimeve me parashtruesin e ankesës dhe organin përkatës.

10. Ndërmjetësimi dhe pajtimi

- 10.1 Për zgjidhjen e një ankese, në çdo moment gjatë hetimit Avokati i Popullit mund të propozojë ose mundësojë ndërmjetësimin dhe pajtimin midis parashtruesit të ankesës dhe organit përkatës me synimin e garantimit të drejtësisë dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të



- mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Avokati i Popullit ia parashtron një propozim të tillë së pari organit përkatës.
- 10.2 Në rast se synon të përgjigjet ndaj propozimit të Avokatit të Popullit, organi përkatës e parashtron përgjigjen e vet brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e propozimit. Avokati i Popullit mund ta zgjasë këtë afat në rast të parashtrimit të arsyeve bindëse prej organit përkatës.
 - 10.3 Në qoftë se organi përkatës pajtohet me propozimin, Avokati i Popullit i jep parashtruesit të ankesës një kopje të propozimit për ndërmjetësim dhe pajtim. Në rast se synon të përgjigjet, parashtruesi i ankesës ia dorëzon përgjigjen e vet Avokatit të Popullit brenda tridhjetë (30) ditësh. Avokati i Popullit mund ta zgjasë këtë afat në qoftë se parashtruesi i ankesës i paraqet arsye bindëse për këtë.
 - 10.4 Në qoftë se të dy palët pajtohen me propozimin, Avokati i Popullit organizon ndërmjetësimin dhe pajtimin midis parashtruesit të ankesës dhe organit përkatës.
 - 10.5 Në rast se ndërmjetësimi ose pajtimi nuk ka sukses, Avokati i Popullit vazhdon hetimin.

11. Raporti përfundimtar

- 11.1. Pas kryerjes së hetimit, Avokati i Popullit nxjerr një raport përfundimtar të cilin ua dorëzon parashtruesit të ankesës, organit përkatës dhe Kryetarit të Dhomave të Specializuara.
- 11.2. Avokati i Popullit publikon raportin përfundimtar në përputhje me rregullën 29(7) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.
- 11.3. Avokati i Popullit mund t'i paraqesë rekomandime organit përkatës në raportin përfundimtar, sipas rrethanave.
- 11.4. Avokati i Popullit mund t'i kërkojë organit përkatës informacion në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

12. Kërkesa për rishqyrtimin e përfundimeve

- 12.1. Në rast se zbulohet një fakt i ri për të cilin parashtruesi i ankesës ose organi përkatës nuk kanë pasur dijeni në kohën e nxjerrjes së raportit përfundimtar; në rast se një fakt i tillë nuk mund të ishte zbuluar nëpërmjet ushtrimit të zellit të duhur dhe mund të kishte qenë faktor vendimtar në nxjerrjen e përfundimeve, brenda një afati të arsyeshëm pasi të jenë vënë në dijeni të faktit, parashtruesi i ankesës ose organi përkatës mund t'i bëjë kërkesë Avokatit të Popullit për rishqyrtimin e përfundimeve të raportit përfundimtar.
- 12.2. Parashtruesi i ankesës ose organi përkatës, sipas rastit, kanë detyrimin të provojnë përmbushjen e kriterëve të Pjesës 12.1.
- 12.3. Në qoftë se bindet se janë përmbushur kriteret për rishqyrtimin e përfundimeve të raportit përfundimtar, Avokati i Popullit informon parashtruesin e ankesës dhe organin përkatës për vendimin e vet. Rishqyrtimi kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Pjesës 9.



13. Mbrojtja e të dhënave

- 13.1. Në trajtimin e ankesave dhe kryerjen e hetimeve, Zyra e Avokatit të Popullit merr parasysh dhe respekton tërësisht detyrimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- 13.2. Në trajtimin e ankesave dhe kryerjen e hetimeve, Zyra e Avokatit të Popullit vepron në përputhje me praktikat dhe procedurat e Dhomave të Specializuara në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe udhëhiqet prej standardeve të Bashkimit Evropian.

14. Konfidencialiteti

- 14.1. Zyra e Avokatit të Popullit zbaton standardet më të larta të konfidencialitetit ku përfshihet respektimi i plotë i praktikave dhe procedurave të Dhomave të Specializuara në lidhje me konfidencialitetin e dokumenteve, seancave dhe çështjeve të tjera.
- 14.2. Avokati i Popullit mund të miratojë kërkesën e një parashtruesi ankese për mospublikimin e emrit në qoftë se parashtruesi i ankesës i paraqet arsye të qarta në mbështetje të kërkesës. Në rast se Avokati i Popullit e miraton një kërkesë të tillë, identiteti i parashtruesit të ankesës nuk bëhet publik.
- 14.3. Në trajtimin e ankesave dhe kryerjen e hetimeve, për hir të mbrojtjes së interesave legjitime të parashtruesit të ankesës ose të një pale të tretë, Zyra e Avokatit të Popullit mund ta trajtojë si konfidencial informacionin konkret të përfshira në ankesë ose në një dokument apo material tjetër që i është dorëzuar.
- 14.4. Në kuadër të procedurës së parashtrimit të ankesave dhe duke i kushtuar rëndësinë e duhur drejtësisë së procedurës dhe të drejtës së organit përkatës për t'u informuar plotësisht mbi pretendimet e paraqitura kundër tij, Avokati i Popullit mund të marrë vendim që ankesën, dokumentacionin mbështetës dhe/ose identitetin e parashtruesit të ankesës t'ia bëjë të njohura organit përkatës.
- 14.5. Zyra e Avokatit të Popullit nuk do të publikojë apo nxjerrë materiale që mund të ndikojnë në efektshmërinë e punës së Dhomave të Specializuara ose të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe do të pajtohet me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar mbi protokollet për sigurinë e komunikimit dhe administrimin e informacionit, sipas rrethanave dhe nevojave.



15. Çështje që nuk trajtohen përmes procedurës së parashtrimit të ankesave

15.1. Avokati i Popullit zgjidh të gjitha çështjet që nuk trajtohen përmes procedurës së parashtrimit të ankesave duke mbajtur parasysh detyrat e veta, parimin e drejtësisë dhe të drejtat dhe liritë themelore të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës.

16. Ndryshimet

16.1. Avokati i Popullit mund të ndryshojë procedurën e parashtrimit të ankesave në rast se kjo gjykohet e domosdoshme për zbatimin e duhur të procedurës për parashtrimin e ankesave.

16.2. Ndryshimet e procedurës së parashtrimit të ankesave nuk ndikojnë në vlefshmërinë e ankesave të marra para hyrjes në fuqi të ndryshimeve përkatëse .

16.3. Ndryshimet në asnjë mënyrë nuk mund të zbatohen në dëm të të drejtave të parashtruesit të ankesës.

17. Hyrja në fuqi

17.1. Procedura e parashtrimit të ankesave hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Avokati i Popullit.